

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Qetësia / es-Sekinetu / السَّكِينَةُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ السَّكِينَةَ فِي قُلُوبِ الْمُؤْمِنِينَ"

“Është Ai që e zbriti qetësinë në zemrat e besimtarëve ...” (el-Fet’h, 4)

*Sekineh*¹ (qetësia) ka të bëjë me tri gjëra. E para është *sekineh* e Beni Israilëve, që iu dha atyre në gjokse (Arka e Besëlidhjes). Komentuesit e Kuranit kanë thanë se kjo ishte një puih e këndshme dhe e përshkruan më tej. Kjo qetësi ka (kishte) tri veçori:

1. Mrekulli për pejgamberët e tyre
2. *Keramet*² për mbretërit e tyre
3. Shenjë fitoreje, tingulli i së cilës bënte zemrat e armiqve të dridheshin nga frika, kur radhët përplaseshin në fushëbetejë

Sekineh e dytë është ajo, që:

1. Shfaqet në gjuhët e të frymëzuarve. Kjo s’është e arritshme, por një gjest miqësie nga ana e të Vërtetit

¹ *Sekineh* do të thotë qetësi dhe përftohet nga rrënja ‘*sekene*’, që do të thotë ‘banoi’ ose ‘qëndroi pa lëvizur/i heshtur’. Kjo është sikurse atëherë kur dikush hyn në shtëpinë e vet pas një udhëtimi të gjatë. Kjo ka të bëjë me siguri, pushim, paqe, rehati, prehje, etj.

² *Kerameh* (shum. *Keramaat*) ka të bëjë me ngjarje të mbinatyrshme, që u atribuohen *ewlijave* (miqve) të Allahut. Kjo fjalë vjen nga rrënja me tri shkronja (كرم) dhe nënkupton bujari dhe nderim. Këto janë dhurata të posaçme nga Allahu për shpirtrat e transformuar, në mënyrë që t’i nderojë më të devotshmit. Nganjëherë kjo u dhurohet fillestarëve për t’i mbështetur dhe për t’i motivuar.

2. Hedh urtësi në gjuhën e të frymëzuarit ashtu siç engjëjt hedhin Shpalljen në zemrat e pejgamberëve
3. E bën të frymëzuarin të flasë të vërtetën më të thellë, duke u sjell kështu jetë shpirttrave dhe duke larguar dyshimet

Sekineh e tretë është ajo, që zbriti në zemrën e pejgamberit ﷺ dhe në zemrat e besimtarëve³. Kjo është diçka që bashkon fuqinë dhe rehatinë:

1. I frikësuari gjen qetësinë në të
2. I vuajturi dhe i rënduari gjen ngushëllim në të
3. Refuzuesi, gjynahqari i rebeluar përul veten para saj

Për sa i përket *sekines* së dinjitetshme⁴, që Ai ua zbriti njerëzve të saj dhe e bëri një veçori të tyre, kjo vjen si rezultat i *sekines* së tretë që sapo përmendëm dhe ka tri nivele:

Niveli i parë është *sekineh* e *khushusë*, e shërbimit⁵ të bërë me:

- Kujdes
- Madhërim
- Vëmendje

Niveli i dytë është *sekineh* e sjelljes me të tjerët, që arrihet me:

- Llogaritje të vetvetes
- Butësi ndaj krijesave
- Mbikëqyrje të të Vërtetit

Niveli i tretë është *sekineh* që:

- Sjell pranimin e caktimit hyjnor

³ Allahu ﷻ tha:

“Kur ata që nuk besuan vënë fanatizëm në zemrat e tyre; një fanatizëm të kohës joislamike. Por, Allahu zbriti qetësinë në të Dërguarin e Tij dhe në besimtarët.” (el-Fet’h, 26)

⁴ Dinjiteti dhe hiri do të jenë manteli i poseduesve të kësaj qetësie.

⁵ *Khushu'* (përlësia solemne) është një kombinim mes qetësisë dhe përlësisë. Ka dhe kuptime të tjera të fjalës *khushu'* po ashtu, si: turpërim, vëmendje, frikë, dhe përnderim.

- Mbron nga *shat'h*⁶ e tepërt
- Ndal poseduesin e vet tek vendi i tij

Sekineh zbret vetëm në zemrën e një peygamberi ose një *welii* (i afërm i Allahut).

⁶ *Shatahaat* janë shprehje anormale enigmatike, të bëra gjatë ekzazës së përjetimeve shpirtërore intensive. Sh-t-h është emër prejfoljor (Shih më shumë rreth kësaj në parathënie të kësaj teme).